



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**- Këshilli Drejtues -**

**V E N D I M**

**Nr. 745, datë 26.06.2009**

**“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit për ofrimin e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike (telefoni e lëvizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë – “Mobile 4 AL” sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në mbledhjen e datës 26.06.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, mori në shqyrtim çështjen e mëposhtme:

**PAJISJA ME AUTORIZIM INDIVIDUAL E SIPERMARRESIT “MOBILE 4 AL” SH.A PER PERDORIMIN E FREKUENCAVE NE BREZAT E-GSM 900 DHE GSM 1800 PER NDERTIMIN E RRJETIT GSM, NE ZBATIM TE LIGJIT 10 118 DATE 23.04.2009 » PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT, PËR 15 VJET, NË BREZIN E FREKUENCAVE E-GSM DHE GSM 1800, BASHKIMIT TË OFERTUESVE, PËRFAQËSUAR NGA POSTË TELEKOMUNIKACIONI I KOSOVËS SHA, SIPAS PROCEDURËS “TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR” TË DATËS 20.02.2009 “**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr. 10 118 date 23.04.2009 “Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga postë telekomunikacioni i kosovës sha, sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar” të datës 20.02.2009” (ligji nr. 10 118) ;
2. Nenet 66-78 dhe 80-86 të Ligjit 9918 datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”;
3. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 510 dt. 04.11.2008.

## VËREHET QE:

E drejta për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike (neni 13), të negociojë për akses dhe interkoneksion (neni 13 pika 4 a), të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal (neni 13 pika 4b), ofrimi i transmetimit të të dhënave dhe internetit, dhënia e linjave me qera, etj janë të drejta që vijnë drejtpërsëdrejti nga ligji 9918 dhe për këtë operatori është i pajisur me to që në momentin kur plotëson procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe rregulloren përkatëse për njoftimin për autorizimin e përgjithshëm.

E drejta për përdorimin e frekuencave dhe numeracionit akordohet nga AKEP nëpërmjet autorizimit individual sipas kërkesës së operatorëve dhe disponueshmërisë së këtyre burimeve të fundme (neni 8, pika g dhe j, Ligji 9918).

Detyrimi i operatorit për të patur një plan për gjendjet e jashtëzakonshme dhe për ta paraqitur atë pranë rregullatorit parashikohet në nenin 111 të ligjit 9918.

Cilësia e shërbimeve që ofrohen do të matet me treguesit që AKEP përcakton në një rregullore të veçantë (neni 102). Për cilësinë e shërbimit sipërmarrësi duhet të plotësojë kriteret e paraqitura në Aneksin 5 të Autorizimit Individual. Metodatat praktike dhe procedura e sakte e matjes së parametrave të kualitetit të shërbimit miratohen nga AKEP.

Detyrimi për ofrimin e shërbimeve të urgjencës dhe për mundësimin e pajtimtarëve për bërjen e thirrjeve pa pagesë drejt shërbimeve të urgjencës parashikohet në nenin 89 të ligjit 9918.

Operatori ka detyrimin të bëjë publike tarifatat dhe të japë informacione të hollësishme sipas nenit 98 të ligjit 9918.

Detyrimi për shërbimin e informacionit, numërorin telefonik dhe kontrata me pajtimtarin janë detyrime që vijnë drejtpërsëdrejti nga ligji 9918 (neni 104, neni 99).

Mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT) mund të vendosen detyrime në lidhje me tarifatat në bazë të nenit 55 të ligjit 9918.

Marrja e masave nga ana e operatorëve për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave parashikohet në nenin 121.

Operatori duhet të mbajë parasysh detyrimet që burojnë nga ligji 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave (nenet 8 dhe 9 të këtij ligji).

Detyrimi për dhënie informacioni rregullatorit dhe informacioni për shërbimet parashikohen në nenin 16 të ligjit 9918.

Rregullat që duhet të ndiqen nga operatori në lidhje me tregtinë e ndershme parashikohen në mënyrë të detajuar në ligjin Nr. 9902, dt 14.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, veçanërisht në Pjesën IV, Praktikatat e tregtimit.

E drejta e përdorimit të pronës publike dhe private nga ana e operatorit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike parashikohet në nenin 93 të ligjit 9918.

Drejtoria e Rregullimit Teknik në ndarjen e kanaleve të frekuencave të brezave në përputhje me parashikimet e tenderit, ka zbatuar parimin e vendosjes së një kanali sigurie për të shmangur interferencat e demshme të shërbimit radio midis operatorëve të rrjeteve celulare

fqinje. Me shkresen nr. 2170/1 prot., date 21.05.2009, Drejtoria e Rregullimit Teknik paraqet ndarjen ne kanale per brezat si me poshte vijon:

E-GSM900 MHz: 2 x 8 MHz (2 x 40 kanale x 200 kHz/kanal = 16 MHz)

GSM 1800 MHz: 2 x 9 MHz (2 x 45 kanale x 200 kHz/kanal = 18 MHz)

Keshtu ne brezin e frekuencave GSM 900 MHz, eshte lene nje kanal sigurie qe nuk perdoret nga asnje operator, midis brezave te frekuencave te caktuar per perdorim nga dy operatore te ndryshem dhe qe jane ne vijim te njeri-tjetrit. Per te zbatuar te njejten praktike dhe ne brezin e frekuencave GSM 1800 MHz, meqenese brezi i frekuencave te parashikuar per operatorin "Mobile 4 AL" sh.a. eshte ne vijim te atij qe ka ne perdorim "AMC" sh.a. me shkresen nr. 2529/8 date 26.06.2009, Drejtoria e Rregullimit Teknik propozon lenien e nje kanal sigurie.

Vendosja e kanalit te sigurise con ne ndryshimin e fillimit dhe mbarimit te brezit te frekuencave GSM 1800 MHz, krahasuar me percaktimet e nenpikes 2.3, Pika 2, Objekt i Tenderit ne Dokumentin e Tenderit. Ky ndryshim eshte 200 kHz, aq sa eshte gjeresia e nje kanali.

Ne përrputhje me parashikimet e tenderit publik me procedurë te hapur *me objekt, "Dhënia e 1 (një) te drejte përdorimi ne brezat e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800"*, Ref. 4-GSM-2008, sipërmarrësi "Mobile 4 AL" sh.a me shkresën e administruar nga AKEP 2090/12, date 12.06.2009, ka depozituar ne AKEP:

1. Shkresën nr. 2090/12 prot date 12.06.2009, brenda afatit 7 (shtatë) dite nga data marrjes se njoftimit te fituesit, me te cilen njofton kryerjen e pagesës **7 200 000 (shtatë milion e dyqind mijë) Euro**, ne llogarinë 2111001E me emër përfituesi "*Depozita e Qeverise*", ne Bankën e Shqipërisë. Bashkëngjitur shkresës, ofertuesi fitues ka paraqitur pranë AKEP dokumentin bankar qe vërteton kryerjen pagesës.
2. Me shkresën Nr. 2019/13 date 17.06.2009, brenda afateve ligjore, nga data e marrjes se njoftimit te fituesit, ofertuesi fitues ka paraqitur pranë AKEP dokumentin bankar qe vërteton kryerjen pagesave:
  - a) Pagesën 8 500 000 (tetë milion e pesëqind mije) Lek për përdorimin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800.
  - b) Pagesën 5 924 352 (pesë milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) Lek per tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, per brezat e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, ne:

Union Bank; Nr. Llogarisë se AKEP : 111113869030117

Gjithashtu, ne respektim te deklarimeve te ofertës se tij, shkresa e administruar nga AKEP me nr. 2509 prot. date 17.06.2009, ofertuesi fitues ka paraqitur pranë AKEP:

- Njoftimin për fillimin e ofrimit te rrjeteve dhe shërbimeve publike te komunikimeve elektronike, formulari i Autorizimit të Përgjithshëm.
- dokumentin që vërteton krijimin e shoqërisë tregtare "MOBILE 4 AL"sh.a sipas legjislacionit Shqiptar dhe kopje te statutit, aktit te themelimit, certifikate e regjistrimit te personit te tatueshëm "MOBILE 4 AL"sh.a me numër unik te identifikimit te subjektit (NUIS) K91811014B dhe kopje te Ekstraktit te regjistrimit tregtar per te dhënat e Shoqërisë anonime.

Shoqëria "MOBILE 4 AL"sh.a është themeluar me date 10.06.2009 dhe është regjistruar ne QKR me date 11.06.2009, me seli ne Tirane, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, kati II/21,

me objekt: *Shërbime ne fushën e komunikimeve elektronike, krijimi dhe implementimi i sistemeve te komunikimeve elektronike, përfshirë rrjetet e internetit (sisteme). Komunikimi baze ne rrjetet e lëvizshme, lokale, ne rrjetet interurbane...* dhe sipas shkresës nr. 2090/15 prot., (AKEP) date 26.06.2009 Ekstrakt i regjistrimit Tregtar për te dhënat e subjektit “Shoqëri Anonime” sh.a te leshuar nga QKR date 26.06.2009 rezulton se bashkimi i ofertuesve i perferfaqesuar nga P.T. Kosove fitues i se drejtes se përdorimit, për 15 vjet, ne brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, me Ligjin 10118, date 23.04.2009 “Për dhënien e se drejtës se përdorimit, për 15 vjet, ne brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit te ofertuesve, përfaqësuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a., sipas procedurës “tender i hapur ndërkombëtar, e datës 20.02.2009”( Ligji nr. 10118) ka krijuar shoqerine “MOBILE 4 AL”sh.a.

Ne vijim te njoftimit te sipërcituar te sipërmarrësit “MOBILE 4 AL” sh.a, AKEP i ka dërguar konfirmimin e njoftimit sipas regjimit te Autorizimit te Përgjithshëm dhe e ka regjistruar ne regjistrin e sipërmarrësve me numër rendor 135 për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve te komunikimeve elektronike te njoftuara prej “MOBILE 4 AL”sh.a :

1. Ofrim i rrjetit publik te komunikimeve te lëvizshme,
2. Ofrim i rrjetit publik për transmetim te dhenash/internet,
3. Ofrim i shërbimeve publike te telefonisë se lëvizshme,
4. Ofrim i shërbimeve publike për transmetim te dhenash/internet,
5. Ofrim i shërbimeve te linjave me qera,
6. Ofrim i shërbimeve te mesazheve te shkruara (short message),
7. Ofrim i shërbimeve me vlere te shtuar,
8. Ofrim i shërbimit te tranzitimit te thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare,
9. Ofrim i shërbimit te roaming ndërkombëtar.

## **PËRFUNDIMISHT**

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga Ligji Nr. 9918 date 19.05.2008 dhe Ligji Nr. 10 118 date 23.04.2009, Këshilli Drejtues i AKEP

## **VENDOSI:**

1. Te pajise sipërmarrësin “Mobile 4 AL” sh.a me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave te brezit E-GSM dhe GSM 1800, siç përshkruhet ne Aneksin 1 bashkëlidhur Autorizimit Individual.
2. Te pajise sipërmarrësin “Mobile 4 AL” sh.a me Autorizimin Individual për përdorimin e numrave dhe serive numerike, siç përshkruhet ne Aneksin 3, bashkëlidhur Autorizimit Individual.
3. Sipërmarrësi duhet te filloje ofrimin e shërbimit te telefonisë se lëvizshme sipas standardit GSM për publikun, nëpërmjet rrjetit te vet, brenda një periudhe prej 6 (gjashte) muajsh nga data e marrjes se Autorizimit Individual.
4. Sipërmarrësi duhet të ofroje shërbimet e cilësuar, siç përshkruhet ne Aneksin 4.
5. Tarifat për shërbimet, për një periudhe një-vjeçare nga koha e fillimit te aktivitetit, do te jene jo me te larta se ato te paraqitura ne Aneksin 5.

6. Sipërmarrësi duhet te plotësoje kriteret për realizimin e cilësisë së shërbimit të paraqitura në Aneksin 6.
7. Rregullimi i çështjeve të pronësisë do të bëhet siç përshkruhet në Aneksin 7, bashkëlidhur. Ndalohet çdo transferim pakete aksionesh apo të drejtash nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës, pa vënë në efikasitet shërbimin e telekomunikacionit në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800. Ky ndalim përfundon në çdo kohë, kur sipërmarrësi, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës ka bërë eficient rrjetin në parametrat: Mbulim 95 % të popullsisë dhe 85 % të territorit.
8. Ky vendim hyn në fuqi në datën 26.06.2008.

## **KRYETARI I KESHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

### **Anëtare të Këshillit Drejtues:**

- |                  |               |
|------------------|---------------|
| <b>1. Afrim</b>  | <b>TONUZI</b> |
| <b>2. Edlira</b> | <b>KASAJ</b>  |
| <b>3. Ilir</b>   | <b>ZELA</b>   |
| <b>4. Jetmir</b> | <b>KARINI</b> |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9918 DATË 19.05.2008**  
**“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**DHE LIGJIT NR. 10 118 DATË 23.04.2009**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**ME VENDIMIN NR. \_\_\_ DATË \_\_. \_\_. 2009.**

**PAJIS ME**

**AUTORIZIM INDIVIDUAL**

**SIPËRMARRËSIN**

**“MOBILE 4 AL” SH.A**

**SIPAS RREGULLORES SË MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES**  
**TË AKEP NR. 510 DATË 04.11.2008, DHE ANEKSEVE BASHKËLIDHUR.**

**DATA E HYRJES NË FUQI : 26. 06. 2009**

**I VLEFSHËM DERI MË : 25. 06. 2024**

## ANEKS NR. 1 :

### **KUSHTET/KRITERET PËR SHFRYTËZIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE**

1. Në përputhje me nenin 71, pika dh) te Ligjit Nr. 9918 date 19.05.2008, ky Autorizim Individual i dhënë sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a përmban detyrime për zbatim te kushteve te veçanta nga *bashkimi i ofertuesve i përfaqësuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosovës sh.a* i shpallur fitues i tenderit publik me procedurë te hapur me objekt, “*Dhënia e 1 (një) te drejte përdorimi ne brezat e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800*”, Ref. 4-GSM-2008, nëpërmjet Ligjit Nr. 10 118 date 23.04.2009.
2. Autorizimi Individual i jep sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a te drejtën e përdorimit te frekuencave E-GSM 900 dhe GSM 1800 me qellim ndërtimin e rrjetit GSM, rrjet i lëvizshëm i komunikimeve publike, për te ofruar Shërbim publik telefonik te lëvizshëm tokësor ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, sipas kanaleve te përcaktuara ne Tabelat 1 dhe 2 te Aneksit Nr. 1, bashkëngjitur.
3. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a, ne mbështetje te Autorizimit Individual, është i detyruar te ndërtojë rrjet publik te lëvizshëm, standardi GSM si dhe te ofrojë shërbime publike te lëvizshme te komunikimeve elektronike, brenda një periudhe 6-mujore nga data e marrjes së Autorizimit Individual, duke respektuar te gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator te fushës.
4. Autorizimi Individual është specifik për te autorizuarin. Ai nuk mund te shitet, jepet me qera, te transferohet apo te jepet si garanci pa miratimin paraprak te AKEP. Asnjë ndryshim i kontrollit të të Autorizuarit, qofte i drejtpërdrejtë apo i tërthortë nuk mund te behet pa lejen paraprake me shkrim te AKEP. AKEP nuk do te lejoje ndryshime ne pronësinë ose ne kontrollin e te autorizuarit, gjate 5 (pese) viteve te para te aktivitetit te tij. Me përjashtim të rastit kur i autorizuari, përfaqësuar nga Postë Telekomoni i Kosovës sh.a ka bërë eficient rrjetin në parametrat; mbulim 95 % të popullsisë dhe 85 % të territorit.
5. Sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a, ne përputhje me Planin Kombëtar te Frekuencave, i janë caktuar kanalet ne brezat (881.9 – 889.9) MHz çiftuar me (926.9 – 934.9) MHz dhe (1729.1 – 1738.1) MHz çiftuar me (1824.1 – 1833.1) MHz, ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, sipas Tabelave 1 dhe 2 te Aneksit 1 bashkëlidhur.
6. Sipërmarrësit ne baze te kërkesës per te plotësuar nevojat për mbulimin me shërbim dhe ne përputhje me Planin Kombëtar te Frekuencave, mund t’i jepen ne përdorim radiofrekuenca te tjera, sipas procedurave te parashikuara ne ligjin Nr. 9918, dt. 19.05.2008.
7. Ne kufijtë shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a për frekuencat GSM 900 dhe GSM 1800, është i detyruar *te respektojë standardet ndërkombëtare përkatëse dhe te bashkëpunojë me operatore mobile te shteteve fqinje dhe organet rregullatorë te këtyre vendeve, me qellim shmangien dhe zgjidhjen e interferencave.*

8. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a me marrjen e Autorizimit Individual do të jete i detyruar që të zbatohet:

1. Planin për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit që do ndërtohet për mbulimin me shërbim, sipas deklaramit të dhënë në Ofertën e tij në Shtojca 5, përfshirë si Aneks 2 të këtij AI;
2. Ofrimin të paketës së shërbimeve të deklaruara sipas Shtojca 6 në Ofertën e tij, të përfshira si Aneks 4 i këtij AI;
3. Për një periudhë të paktën një-vjeçare nga koha e fillimit të aktivitetit, *tarifat e shërbimeve të paketës, të përcaktuara si kriter vlerësimi, tek pika I c), e pikës 12.1, “Tarifat e shpirtës së shërbimeve”, të jenë jo më të larta se ato të deklaruara sipas Shtojca 7 në Ofertën e tij, të përfshira si Aneks 5 i këtij Autorizimi Individual;*
4. Standardet teknike të CEPT dhe ITU të deklaruara sipas Shtojca 8 në Ofertën e tij, të përfshira si Aneks 6 i këtij Autorizimi Individual;

Zbatimi i detyrimeve të mësipërme nuk duhet të kushtëzohet nga sipërmarrësi apo parashikohet të kushtëzohet nga sipërmarrësi, me të drejta të cilat mund të lindin si pasoje të masave rregullatore ose detyrime për operatorët me FNT të mëvonshme, por që nuk janë ende në fuqi në kohën e njoftimit të tenderit, si p.sh roaming kombëtar apo portabiliteti i numrit.

9. Sipërmarrësi është i detyruar që brenda 60 ditëve kalendrike nga data e marrjes së Autorizimit Individual të paraqesë pranë AKEP një projekt të detajuar për realizimin e Planit për shtrirjen dhe ndërtimin e rrjetit, mënyrën e realizimit të lidhjeve ndërmjet stacioneve baze si dhe vendndodhjen e tyre, me afate të përcaktuara, të ndara për çdo vit të periudhës 3 vjeçare. Sipërmarrësi është i detyruar të raportojë pranë AKEP lidhur me përqindjen e territorit që mbulohet me shërbim prej rrjetit të ndërtuar prej tij sipas grafikut 3 vjeçar.

10. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a është i detyruar të dërgojë të dhëna lidhur me frekuencat, sa here ti kërkohet nga AKEP.

11. Pas periudhës 3 vjeçare nga data e marrjes së Autorizimit Individual, sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a është i detyruar :

- a) Të ofrojë shërbimet e komunikimit të lëvizshëm (minimalisht Komunikim Zanor dhe SMS) në të gjitha rrethet e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjitha rrugët kombëtare.
- b) Minimumi i mbulimit me shërbim do të jete 95 % e zonave të banuara për çdo rreth.
- c) Në rrugët kombëtare minimumi i mbulimit me shërbim do të jete 95 % e gjatësisë së rrugës.

12. Vlefshmëria e përdorimit të frekuencave E-GSM dhe GSM 1800 përfundon në datën 25.06.2024.

13. Rinovimi i autorizimit individual do të bëhet në fund të përfundimit të periudhës së vlefshmërisë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 9918 datë 19.05.2008 apo legjislacionit në fuqi në kohën përkatëse.



14. Sipërmarrësi për ndërtimin e rrjetit dhe shfrytëzimin e frekuencave të marra në përdorim duhet të zbatojë rekomandimet dhe standardet e CEPT. Rekomandimet e ITU të përdoren vetëm në ato raste kur nuk ka rekomandime apo vendime të CEPT-it në lidhje me përdorimin e frekuencave.
15. Sipërmarrësi përpara ofrimit të çdo shërbimi, duhet të njoftojë AKEP për tarifën për këtë shërbim. AKEP mund të imponojë kontroll e rregullim të tarifave kur sipërmarrësi përcaktohet nga AKEP si Organizëm me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT).
16. Sipërmarrësi do të kryejë çdo vit pagesën për caktimin dhe përdorimin e frekuencave në përputhje me nenin 119 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 sipas VKM përkatës si dhe pagesën për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit bazuar në Udhëzimin Nr. 28, datë 6.10.2008, i ndryshuar.
17. Nëse operatori nuk përmbush të paktën një prej detyrimeve të mësipërme, AKEP ndërmerr penalitete në përputhje me nenin 135 dhe në vijim të Ligjit 9918 datë 19.05.2008, deri në heqjen e Autorizimit Individual.



38	1021	889,4	1021	934,4	45
39	1022	889,6	1022	934,6	45
40	1023	889,8	1023	934,8	45

Gjithsej: 2 x 40 (dyzet) kanale me gjeresi B=200 kHz

**TABELA NR. 2 :**

<b>Brezi i frekuencave, kanalet dhe frekuencat perkatese ne brezin GSM 1800</b>					
<b>Up Link(Pajisje pajtimtari- BTS)</b>			<b>Down Link(BTS - Pajisje pajtimtari)</b>		
<b>Brezi Frekuencave</b>			<b>Brezi Frekuencave</b>		
Fillimi:		<b>1729.1</b>	Fillimi:		<b>1824.10 MHz</b>
Mbarimi:		<b>1738.1</b>	Mbarimi:		<b>1833.10 MHz</b>
Gjeresia e Brezit: <b>9 MHz</b>			Gjeresia e Brezit: <b>9 MHz</b>		
<b>Nr.rend or i kanalit</b>	<b>Kanalet me gjeresi 200 kHz</b>		<b>Kanalet me gjeresi 200 kHz</b>		<b>DS (f'c-fc)  [MHz]</b>
	Nr.kanalit sipas standardit	fc [MHz]	Nr.kanalit sipas standardit	f'c [MHz]	
1	607	1729,2	607	1824,2	95
2	608	1729,4	608	1824,4	95
3	609	1729,6	609	1824,6	95
4	610	1729,8	610	1824,8	95
5	611	1730,0	611	1825,0	95
6	612	1730,2	612	1825,2	95
7	613	1730,4	613	1825,4	95
8	614	1730,6	614	1825,6	95
9	615	1730,8	615	1825,8	95
10	616	1731,0	616	1826,0	95
11	617	1731,2	617	1826,2	95
12	618	1731,4	618	1826,4	95
13	619	1731,6	619	1826,6	95
14	620	1731,8	620	1826,8	95
15	621	1732,0	621	1827,0	95
16	622	1732,2	622	1827,2	95
17	623	1732,4	623	1827,4	95
18	624	1732,6	624	1827,6	95
19	625	1732,8	625	1827,8	95
20	626	1733,0	626	1828,0	95
21	627	1733,2	627	1828,2	95
22	628	1733,4	628	1828,4	95
23	629	1733,6	629	1828,6	95
24	630	1733,8	630	1828,8	95
25	631	1734,0	631	1829,0	95
26	632	1734,2	632	1829,2	95
27	633	1734,4	633	1829,4	95
28	634	1734,6	634	1829,6	95
29	635	1734,8	635	1829,8	95
30	636	1735,0	636	1830,0	95
31	637	1735,2	637	1830,2	95
32	638	1735,4	638	1830,4	95
33	639	1735,6	639	1830,6	95
34	640	1735,8	640	1830,8	95
35	641	1736,0	641	1831,0	95
36	642	1736,2	642	1831,2	95
37	643	1736,4	643	1831,4	95
38	644	1736,6	644	1831,6	95
39	645	1736,8	645	1831,8	95
40	646	1737,0	646	1832,0	95
41	647	1737,2	647	1832,2	95

42	648	1737,4	648	1832,4	95
43	649	1737,6	649	1832,6	95
44	650	1737,8	650	1832,8	95
45	651	1738,0	651	1833,0	95

Gjithsej: 2 x 45 (dyzet e pese) kanale me gjeresi B=200 kHz

## ANEKS NR. 2 :

### “PLANI PËR SHTRIRJEN DHE KONFIGURIMIN E RRJETIT PËR MBULIMIN ME SHËRBIM”

Sipërmarrësi do të ndërtojë dhe konfiguruar rrjetin për të realizuar shtrirjen gjeografike të mbulimit me shërbim, sipas afatit dhe përcaktimeve të tabelës së mëposhtme :

**TABELA NR. 3 : Për 3 (tre) vitet e para pas marrjes së Autorizimit Individual:**

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shtrirja gjeografike e rrjetit për mbulim me shërbim
Deri në fund të vitit të parë	81 % e territorit
Deri në fund të vitit të dytë	83 % e territorit
Deri në fund të vitit të tretë	85 % e territorit

### “PLANI I SHTRIRJES SË RRJETIT GSM” :

*Shënim : Ky plan do të detajohet nga sipërmarrësi gjatë dymujorit të parë pas marrjes së Autorizimit.*

#### VITI I PARË

**A. Faza 0 (6 muaj nga marrja e Autorizimit Individual) :**

1. Implementimi i rrjetit *core* dhe i stacioneve baze të nevojshme për të shtrirë mbulimin në zonën Tiranë - Durrës – Rinas.
2. Ndërtimi i 220 – 250 stacioneve baze GSM.

**B. Faza 1 (8 muaj nga marrja e Autorizimit Individual) :**

1. Gjatë kësaj faze mbulimi do të shtrihet në qytetet kryesore duke përdorur kapacitete transmetuese të operatorëve ekzistues. Prezenca e rrjetit të sipërmarrësit do të jetë në të gjithë Shqipërinë.

**C. Faza 2 (12 muaj nga marrja e Autorizimit Individual) :**

1. Gjatë kësaj faze mbulimi do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë duke përdorur kapacitete transmetuese të operatorëve ekzistues. Do të arrihet që mbulimi i territorit të jetë të paktën 81 % duke qenë prezent në më shumë se 95 % të popullatës.

#### VITI I DYTË

1. Gjatë vitit të dytë parashikohet shtimi i stacioneve deri në 350 stacione. Kështu do të arrihet një mbulim i territorit të Shqipërisë deri në 83 % të territorit. Në të njëjtin vit do të projektohet rrjeti backbone duke ndërtuar dhe stacionet baze që do të mbajnë këtë rrjet.

#### VITI I TRETË

1. Gjatë vitit të dytë parashikohet shtimi i stacioneve deri në rreth 400 stacione. Këto stacione do të jenë kryesisht për shtimin e kapaciteteve në zonën ekzistuese të mbulimit dhe një pjesë e vogël për rritjen e zonës së mbulimit në mbi 85 %. Në të njëjtin vit do të përfundohet rrjeti backbone duke u shkëputur nga rrjeti i transmetimit të operatorëve ekzistues.

**ANEKSI NR. 3 :**

**NUMERACIONI**

1. Sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a i caktohet:

**KODI NDËRKOMBËTAR I PIKËS SE SINJALIZIMIT – ISPC ( 2-152-5)**

i cili aplikohet ne formatin binar 3-8-3 (gjithsej 14 bit) ne përputhje me Rekomandimin Q.708-ITU

2. Sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a i caktohet:

**KODI I RRJETIT TE LEVIZSHEM - MCC/MNC ( 276 04 )**

i cili aplikohet ne përputhje me Rekomandimin Q.212-ITU

3. Sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a i caktohet:

**KODI KOMBËTAR I DESTINACIONIT – NDC ( 66 )**

i cili ka ne përbërje te tij blloqet numerike sipas tabelës me poshtë :

<b>HLR</b>		<b>SN - Numri i përdoruesit [fillim-mbarim]</b>	<b>Caktimi nga AKEP</b>
<b>h<sub>1</sub></b>	<b>h<sub>2</sub></b>		<b>“Mobile 4 AL” sh.a NDC=66</b>
<b>2</b>	0	00000 - 99999	
	1	00000 - 99999	
	2	00000 - 99999	
	3	00000 - 99999	
	4	00000 - 99999	
	5	00000 - 99999	
	6	00000 - 99999	
	7	00000 - 99999	
	8	00000 - 99999	
	9	00000 - 99999	
<b>3</b>	0	00000 - 09999	
	1	00000 - 99999	
	2	00000 - 99999	
	---	-----	
	8	00000 - 99999	
	9	00000 - 99999	
<b>9</b>	0	00000 - 99999	
	---	-----	
	9	00000 - 99999	

**HLR - Treguesi i Adresës se Regjistrimit ( 2 shifror)**

**SN - Numri i përdoruesit – SN (5 shifror)**

**20 deri 99**

**00000 deri 99999**

4. Sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a me marrjen e Autorizimit Individual i caktohen për përdorim:  
BLLOQET NUMERIKE SIPAS NDC (66):

HLR		SN - Numri i përdoruesit [fillim-mbarim]	Caktuar nga AKEP
h <sub>1</sub>	h <sub>2</sub>		SIPERMARRESI “Mobile 4 AL” sh.a NDC = 66
2	0	00000 - 99999	Sipas Autorizimit Individual Me Vendimin Nr. ____, Date __.__.2009
	1	00000 - 99999	
	2	00000 - 99999	

5. NUMERACIONI I SHKURTUAR:

Kodi i Shkurtër	Funksioni	Caktuar nga AKEP
		“Mobile 4 AL” sh.a
0	Prefiksi për thirrje kombëtare	
00	Prefiksi për thirrje ndërkombëtare	
112	Numri i urgjencës	
118	Rubrika e shërbimeve të informacionit	
1211	Sinjalizim vështirësish në komunikimet	
1212	Sinjalizim vështirësish në komunikimet	
124	Informacion për numërorin	
126	Policia Rrugore	
127	Urgjenca mjekësore	
128	Zjarrfiksat	
129	Policia e rendit	
139	Asistence Shërbimi (Përmes Operatorit) Për Abonentët Mobile me Karte të Parapaguar	
140	Aktivizimi i Shërbimeve dhe Ankesat të Klienteve	
141-X	Asistence Shërbimi (Përmes Mesazheve Udhëzuese të Regjistruara Paraprakisht në Sistem) për Abonentët Mobile me Karte të Parapaguar (141-X, ku X=1,2,3...0) (141-X, ku X=1,2,3...0)	
142	Asistence Shërbimi (Përmes Mesazheve Udhëzuese të Regjistruara Paraprakisht në Sistem) për Abonentët Mobile me Karte të Parapaguar	
144	Asistence Shërbimi (Përmes Operatorit) për Abonentët me Kontrate	
151-XX	Shërbime Argëtimi / Lajmesh / Oraresh	
165	Thirrje Telefonike me Tarife të Reduktuar për Pajtimtarët e Rrjetit që bëjnë pjesë në Grupe të Veçanta të Tregut	

6. Sipërmarrësi, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me Operatorët e tjerë Publik të Telekomunikacioneve, duhet të sigurojë për përdoruesit e rrjetit të tij, komunikimin pa pagesë me Shërbimet e Urgjencës.



## **ANEKSI NR. 4:**

### **SHËRBIMET QE DO TE OFROHEN NGA SIPËRMARRËSI “MOBILE 4 AL” SH.A**

Ofertuesi do te ofroje për konsumatorin shërbimet si me poshtë :

*Tabela e shërbimeve qe do ti ofrohen konsumatorit:*

<b>Nr.</b>	<b>Shërbimet</b>	<b>Shënime</b>
<b>1.</b>	Shërbim Publik Telefonik i Lëvizshëm Tokësor GSM	<i>Përfshin thirrjet telefonike brenda rrjetit, drejt rrjeteve te tjera fikse kombëtare, drejt rrjeteve te tjera te lëvizshme kombëtare si dhe thirrje ndërkombëtare.</i>
<b>2.</b>	SMS	
<b>3.</b>	Akses ne internet	

- 1. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a do të ofrojë shërbimin e roaming-ut ndërkombëtar brenda një periudhe 6 mujore nga data e fillimit te ofrimit te shërbimi GSM dhe do te beje përpjekjet maksimale për të pasur dhe lidhur marrëveshje me operatore mobile ndërkombëtare.*
- 2. Sipërmarrësi ka te drejtën dhe obligimin te negocioje me operatoret e tjerë lidhur me interkoneksionin, ne përputhje me përcaktimet përkatëse te Ligjit nr. 9918, date 19.5.2008 dhe Rregulloreve te AKEP.*
- 3. Ne rast se sipërmarrësi nuk arrin te përfundojë një marrëveshje interkoneksioni me çfarëdo Operator Publik Telekomunikacioni, duhet ti drejtohet AKEP sipas procedurave te ligjit nr. 9918, date 19.5.2008 dhe Rregulloreve te AKEP.*

## **ANEKSI NR. 5 :**

### **TARIFAT QE DO TE APLIKOHEN NGA SIPËRMARRËSI PËR ÇDO SHËRBIM**

1. Sipërmarrësi do te beje te disponueshëm për publikun, për një periudhe te paktën një-vjeçare nga koha e fillimit te aktivitetit, midis paketave te tjera, paketën (paketat) e shërbimeve me tarifat maksimale si me poshtë:

*Tabela për tarifat qe do te aplikohen për çdo shërbim:*

<b>Nr.</b>	<b>Shërbimi</b>	<b>Tarifa</b>	<b>Shënime</b>
<b>1</b>	<b>Thirrje telefonike</b>		
1.1	Thirrje telefonike brenda rrjetit		
1.1.1	Për 14 min e para te thirrjes gjate një muaji pavarësisht nga numri i thirrjeve	0 leke/sekonde	<b>Kjo tarife i përket shportës se OECD-se për thirrjet brenda rrjetit.</b>
1.1.2	Duke filluar pas minutës se 15-te te thirrjes gjate një muaji	0.75 leke/sekonde	<b>Kjo tarife është maksimale dhe është për thirrjet brenda rrjetit jashtë shportës se OECD-se.</b>
<b>1.2</b>	<b>Thirrje telefonike drejt rrjeteve te tjera fikse kombëtare</b>		
1.2.1	Për 16.8 minutat e para te thirrjes gjate nje muaji pavarësisht nga numri i thirrjeve	0.01 leke/sekonde	<b>Kjo tarife i përket shportës se OECD-se për thirrjet drejt rrjeteve te tjera fikse kombëtare.</b>
1.2.2	Duke filluar pas minutës se 16.8-te te thirrjes gjate një muaji	0.75 leke/sekonde	<b>Kjo tarife është maksimale dhe është për thirrjet drejt rrjeteve te tjera jashtë shportës se OECD-se.</b>
<b>1.3</b>	<b>Thirrje telefonike drejt rrjeteve te tjera te lëvizshme kombëtare</b>		
1.3.1	Për 6.3 minutat e para te thirrjes gjate një muaji pavarësisht nga numri i thirrjeve	0.1 leke/sekonde	<b>Kjo tarife i përket shportës se OECD-se për thirrjet drejt rrjeteve te tjera te lëvizshme kombëtare.</b>
1.3.2	Duke filluar pas minutës se 6.3-te te thirrjes gjate një muaji	1 leke/sekonde	<b>Kjo tarife është maksimale dhe është për thirrjet drejt rrjeteve te tjera te lëvizshme kombëtare jashtë shportës se OECD-se.</b>
<b>1.4</b>	<b>Thirrje ndërkombëtare pavarësisht nga destinacioni</b>	31 leke/sekonde	<b>Kjo tarife është maksimale dhe është për thirrjet drejt rrjeteve te tjera ndërkombëtare jashtë shportës se OECD-se.</b>
<b>2</b>	<b>Shërbimi SMS</b>		
2.1	Për 30 SMS-te e para te nisura gjate një muaji	0 leke/SMS	<b>Kjo tarife i përket shportës se OECD-se për SMS te dërguara.</b>
2.2	Për SMS-te e dërguar gjate muajit duke filluar nga SMS i 31-te	19 leke/SMS	<b>Kjo tarife është maksimale dhe është për SMS te dërguar jashtë shportës se OECD-se</b>
<b>3</b>	<b>Shërbimi Internet</b>	5,000 leke/1GB	<b>Kjo tarife është maksimale dhe jashtë shportës se OECD-se</b>
<b>4</b>	<b>Pajtimi mujor</b>	0 leke/muaj	
<b>5</b>	<b>Tarifa e regjistrimit</b>	<b>0 leke</b>	

2. Për çdo ndryshim ne shërbimet qe ofron, ne kushtet dhe tarifat e shërbimeve sipërmarrësi duhet te njoftoje me pare AKEP.

## **ANEKSI NR. 6 :**

### **KRITERE PËR SIGURIMIN E TREGUESVE TE CILËSISË**

Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme për cilësinë e shërbimit:

- a. Të sigurojë një sistem të projektuar dhe mirëmbajtur në mënyrë të tillë që të ofrojë Shërbime të pandërprera 24 orë në ditë gjatë gjithë vitit.
- b. Koha nga marrja e kërkesës për çdo Shërbim dhe sigurimi i këtij Shërbimi nuk duhet të kalojë tre ditë pune.
- c. Të gjitha defektet në rrjet duhet të lokalizohen dhe eliminohen në afatin më të shkurtër të mundshëm, duke siguruar një disponibilitet të Shërbimeve për jo më pak se 97% të kohës, duke përjashtuar mirëmbajtjen e planifikuar të rrjetit, e cila duhet t’i njoftohet AKEP një herë në vit.
- d. I Autorizuarit duhet të minimizojë kohën e ndërprerjes për mirëmbajtjen thelbësore apo zhvillim të rrjetit.
- e. Niveli i bllokimit të thirrjeve ( hyrëse dhe dalëse) në central (MSC) nuk duhet të kalojë vlerën 1 %.
- f. Niveli i bllokimit të thirrjeve ( hyrëse dhe dalëse) në transmetimin radio nuk duhet të kalojë nivelin 3 %.
- g. Niveli i rënies së thirrjes nuk duhet të kalojë 3%.
- h. Niveli i sinjal/zhurme duhet të jetë të paktën sa minimumi i dhënë në standardet përkatëse të ETSI;
- i. Duhet të sigurohet transferimi automatik i thirrjeve ndërmjet të gjithë celulave fqinje.

Metodat praktike dhe procedura e sakta e matjes së parametrevë të kualitetit të shërbimit miratohen nga AKEP

## **ANEKSI NR. 7:**

### **RREGULLIMI I CESHTJEVE TE PRONËSISË PAS FILLIMIT TE OFRIMIT TE SHËRBIMIT GSM**

1. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a është shoqëri tregtare e regjistruar ne Republikën e Shqipërisë.
2. As sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a, por as ndonjë person tjetër qe kontrollon këtë sipërmarrës, nuk duhet te zotëroje, kontrolloje apo te ketë interesa ne ndonjë sipërmarrës tjetër për te ofruar shërbime publike te telefonisë se lëvizshme ne Republikën e Shqipërisë.
3. Sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a duhet te kërkoje paraprakisht miratimin me shkrim te AKEP për çdo transferim te aksioneve, i cili mund te çojë ne ndryshim te pronësisë për me shume se 50 % te pjesës se kapitalit themelues te deklaruar nga sipërmarrësi.
4. Ndalohet, pa vënë në efijencë shërbimin e telekomunikacionit ne brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, çdo transferim pakete aksionesh apo të drejtash, sipas nenit 1 te ligjit 10 118 date 23.04.2009, nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës sha, përfshirë dhe bashkimit te ofertuesve te tjerë. Ky ndalim përfundon në çdo kohë, kur sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës ka bërë efijent rrjetin në parametrat: Mbulim 95 % të popullsisë dhe 85 % të territorit.
5. Miratimi i transferimit te aksioneve nuk mund te shtyhet me shume se 30 (tridhjete) dite nga AKEP, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye te shëndosha për te besuar se ky transferim do te shpinte ne shkelje te kushteve te Autorizimeve ose ne dëmtim te konkurrencës për shërbimet publike telefonike te lëvizshme.